

VENDIM
Nr. 139, datë 21.8.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“YLLIAD” SHPK, NR. 9, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 97, DATË 28.7.2015**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 8, nenit 9, nenit 10, pikat 1 dhe 3, si dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 96/5 prot., datë 17.8.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. ref. YTL 04-2020, datë 29.7.2020, protokolluar në ERE me nr. 1013/1 prot., datë 29.7.2020, shoqëria “YLLIAD” sh.p.k. ka depozituar në ERE aplikimin për rinovimin e licencës nr. 9, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 97, datë 28.7.2015.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 97, datë 28.7.2015, ka vendosur:

- “Të rinovojë licencën e shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 22.12.2010, për një afat 5-vjeçar.

- Në zbatim edhe të pikës 1, germa “a”, të vendimit të Bordit nr. 133/2020, ku është vendosur të shtyhet deri më 1. 9.2020, afati i dorëzimit të aplikimit për rinovim licence të të gjitha subjekteve, afati për aplikim për rinovim licence i të cilave përfundon, apo ka përfunduar deri në 30 qershor 2020, shoqëria legjitimohet në kërkesën për rinovimin e licencës duke e vlerësuar atë të kryer brenda parashikimeve ligjore të miratuara nga ERE.

- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit dhe pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Aplikimi i shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b” “c”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar pjesërisht.

Mungon germa “c” (Dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.). Shoqëria ka depozituar shkresën e OTP BANK, ku përcaktohet volumi në euro i shoqërisë në këtë bankë. Po ashtu shoqëria ka deklaruar kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të energjisë, i cili rezulton më

i lartë se gjendja bankare e shoqërisë. Sa më sipër, edhe pse rezulton që bilancet e saj janë mbyllur me fitim, do t'i kërkohet shoqërisë të informojë ERE-n në lidhje me mënyrën se si parashikon të garantojë këtë diferencë në shumën e parashikuar.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germa "a", "b", "c", "d"), është plotësuar pjesërisht.

Mungon germa "b" (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj.). Duke qenë se shoqëria ka deklaruar kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike është më i lartë se shuma që rezulton nga gjendja bankare e shoqërisë, edhe pse referuar pasqyrave financiare të shoqërisë, rezulton që bilancet e saj janë mbyllur me fitim, do t'i kërkohet shoqërisë të informojë ERE-n në lidhje me mënyrën se si parashikon të garantojë këtë diferencë në shumën e parashikuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 9, seria T15, të shoqërisë "YLLIAD" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 28.7.2015, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti